



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.



- Marrëveshja për energji e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë
- Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë, bazë për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë Elektrike deri në vitin 2030
- Krijimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri

# BULETINI

# 8

VITI VI, 2013



## PËRMBAJTJA

▶ Marrëveshja për energji e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë	3
▶ Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë, bazë për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë Elektrike deri në vitin 2030	5
▶ Sistemi SCADA/EMS në KOSTT	6
▶ Qeveria Gjermane akordon kredinë e dytë për zhvillimin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës	7
▶ Krijimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri	8
▶ KOSTT sh.a investon në përmirësimin e kualitetit të furnizimit me energji elektrike në rajonin e Kosovës Juglindore	10
▶ Bordi i Drejtorëve të KOSTT emëron z.Naim Bejtullahu Kryeshf Ekzekutiv të KOSTT sh.a	10
▶ Përvojë nga trajnimi në Japoni për konservim të energjisë në sektorin publik dhe komercial	11
▶ Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Janar-Shtator 2013	11

Buletini nr.8, Viti VI, 2013

Buletini është publikim i KOSTT sh.a,

Rr. Iljaz Kodra p.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381(0) 38 501 301 174 ; email: [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:

Zyrën për Komunikim dhe Relacione me Publikun në:

[zana.rama@kostt.com](mailto:zana.rama@kostt.com) ose [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)

Web: [www.kostt.com](http://www.kostt.com)

## Marrëveshja për energji e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë

**S**istemi elektrik i Kosovës është i ndërlidhur me sistemet e vendeve fqinje pothuajse në të gjitha nivelet e tensionit të lartë (110, 220 dhe 400kV). Numri i linjave të interkoneksionit na rendit në nivelin e një interkoneksioni të fuqishëm dhe si një nryje shumë e rëndësishme për transaksionet e energjisë elektrike veri – jug dhe veri –jugperëndim. Në rastet e operimit të sistemeve elektrike, ashtu si thuhet në gjuhën e ekspertëve, në sinkron, ka rregulla dhe zbatimimi ose mos zbatimimi ka ndikim në sistemet e njëri tjetrit me konsekuenca edhe komerciale për pjesëmarrësit në tregjet e energjisë elektrike.



*Naim Bejtullahu*

Fillimisht pas luftës së vitit 1999, nëpërmjet UNMIK-ut janë firmosur dy marrëveshje teknike në mes të Serbisë dhe Kosovës të cilat me kalimin e kohës dhe me fillimin e ristrukturimit të sektorit të energjisë mbi bazën e rregullave të *aquis communautaire* të Bashkimit Evropian, nuk kanë mundur që ti përgjigjen kërkesave të reja dhe operimit të sistemit elektrik të njohur ndërkombëtarisht. Këto ndryshime në sektorin e energjisë elektrike në regjion janë shfrytëzuar nga Serbia që të mohoj sistemin elektrik të Kosovës respektivisht transmisionit, entitet që e përfaqëson në marrëdhëniet me sistemet transmetuese. Janë provuar zgjidhje deri sa sistemi transmetues ka qenë vertikalisht i organizuar përbrenda KEK-ut por gjithnjë nuk ka mundur të gjendet gjuhë e mirëkuptimit me palën serbe.

Me shthurjen e sistemit të transmisionit dhe themelimin e KOSTT si kompani mëvete, intensiteti për të zgjedhur këtë kontest është rritur por rezultatet janë arritur vetëm në përfaqësimin e KOSTT në mekanizmat dhe organizimet që kanë dalur nga një Traktat që vendet e Evropës Juglindore në ndërkohë kanë firmosur por jo edhe në mekanizmat që

kanë sjellë edhe të hyra, si puna e tranzitit të energjisë elektrike dhe ndarjes së kapaciteteve në interkoneksion.

Rasti i një sjelljeje të tillë i Serbisë me pretekstin se janë pronar të asetëve të rrjetit të transmisionit të Kosovës, ka përfunduar në një kontest ligjor përbrenda Komunitetit të Energjisë për EJK si organ i Traktatit, ku e drejta i është dhënë KOSTT-it.

Komuniteti i Energjisë që selinë e ka në Vjenë ka ndërmarrë paraprakisht aktivitete negociimi në mes të KOSTT-it dhe palës serbe por këto biseda kanë përfunduar pa ndonjë rezultat.

Në fillim të vitit 2011 në kuadër të dialogut teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë që Qeveritë e dy vendeve kanë filluar, gjithashtu temë e bisedimeve ka qenë energjia. Janë zhvilluar shumë takime negociimi por rezultati nuk është arritur.

Negocimet që janë organizuar në mes të dy Kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë nën

ndërmjetësimin e Komisionit Evropian përfundimisht kanë sjell rezultatit që shprehet me marrëveshjen e firmosur në mes të Kryeministrave, Z.Thaçi dhe Z.Daçiq, ndërmjetsuar respektivisht vërtetuar edhe nga Zonj. Eshton.

Marrëveshja në fjalë e diskutuar në nivelin edhe të ekspertëve ku KOSTT-i gjithashtu ka pasur rol të përfaqësimit, tani njihet KOSTT-in ndërkombëtarisht si dhe jep mundësi zgjidhjeje për veriun e Kosovës në nivelin e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike.

Materializimi i kësaj marrëveshjeje do të vazhdoj me grupin e implementimit që është themeluar nga dy vendet duke iu referuar instrumenteve që tani më janë specifikuar në

Marrëveshjen për Energji si puna e Marrëveshjes për Operim në mes të dy transmisioneve të Kosovës dhe Serbisë dhe një numër marrëveshjeje tjera që i referohen relaksimit të furnizimit në veriun e Kosovës i cili nuk ka mundur të ekzekutohet si në pjesën jugore të vendit si konsekuencë e çështjeve të hapura politike të cilat në marrëveshjet në mes të dy kryeministrave kanë marrë kahjen e zgjidhjes.

Natyrisht, edhe procesi i implementimit të marrëveshjes për energji mund të jetë i vështirësuar, meqë pala serbe gjithnjë mundohet të krijoj pengesa me pretekste të përfitimeve dhe kontrollit ndaj sistemit elektrik dhe tregut të energjisë elektrike të Kosovës.

*Naim Bejtullahu*





## Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë, bazë për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë Elektrike deri në vitin 2030

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a me 23 Mars 2013, organizoi Tryezë Pune ku u prezantua Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë (SFEE).

Objektivë e Studimit ishte analizimi i disa skenareve për të parashikuar zhvillimin e kërkesës për energji elektrike në vend, adekuacinë e gjenerimit të energjisë elektrike, funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme, të gjitha këto elemente që ndikojnë në sigurimin e furnizimit me energji elektrike në Kosovë deri në vitin 2030.

Studimi në fjalë, gjithashtu përmbanë edhe komponentën e operimit të përbashkët me Republikën e Shqipërisë si mundësi e sigurimit të furnizimit me energji elektrike, dhe e cila është treguar se ka tendenca të ndikimit në rënien e çmimeve të energjisë elektrike. Gjithashtu, është konstatuar se operimi i përbashkët i sistemit elektro-energjetik Kosovë-Shqipëri, sjell përparësi sidomos duke pasur parasysh se operimi i sistemit të Kosovës si i vetëm është më i varur nga importi dhe më pak i aftë për eksport, se sa operimi i sistemit të përbashkët elektroenergjetik.

Optimizimi i dy sistemeve elektrike të diversifikuara për sa i përket resurseve, i Kosovës linjiti ndërsa i Shqipërisë potencialet ujore u sjellin benefite të dy vendeve. Gjeneratorët termik në Kosovë do të operonin me ngarkesë të pandryshuar e që si rezultat ka rendimentin e shtuar, ndërsa gjeneratorët hidrik do të punonin në kohën e ngarkesave maksimale kur edhe çmimet do jenë më të larta. Studimi provon që ky model i operimit sjell mirëqenje më të larta për të dy vendet.

Për më tepër, në këtë studim gjithashtu arsyetohet edhe krijimi i një tregu të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri, për ta zgjeruar edhe mëtej në tërë Evropën Juglindore.

Sa i përket shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë(BRE), siç janë



energjia nga era dhe energjia solare, përkundër kostos më të lartë të gjenerimit krahasuar me gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet termo, shfrytëzimi i BRE është strategji klimatike në tërë Evropën dhe kjo përbën një kusht që duhet plotësuar, edhe Kosova.

Me Studimin mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë, përfundimisht konkludohet se shtimi i sigurisë së furnizimit do të rezultojë me:

- Rritjen e theksuar të Bruto Produktit Vendor në Kosovë
- Rritjen e numrit të të punësuarve
- Do të dërgojë sinjale pozitive për tërheqjen e investimeve në Kosovë

Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë, mund të shërbejë si bazë për orientimin e strategjisë së zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të energjisë elektrike deri në vitin 2030.

Studimi në fjalë është financuar nga Qeveria Gjermane përmes Bankës për Zhvillim-KfW dhe është realizuar nga kompania konsulente Vattenfall/Germany.

Në Tryezën e Punës ku u prezantua Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë, ishin prezent të gjitha palët e interesit vendorë dhe ndërkombëtarë të sektorit të energjisë në Kosovë përfshirë dhe shoqërinë civile si dhe përfaqësuesit e institucioneve të sektorit të energjisë të Shqipërisë.

## Sistemi SCADA/EMS në KOSTT

**S**istemi SCADA/EMS i mundëson Operatorit të Sistemit që në vazhdimësi dhe kohë reale të menaxhoj me Sistemin e Transmisionit të Kosovës duke i siguruar konsumatorëve furnizim të vazhdueshëm dhe kualitativ të energjisë elektrike.

Grumbullimi i të dhënave, matjeve në kohë reale me saktësi të lartë nga nënstationet, monitorimi dhe operimi i stabilimenteve energjetike i mundëson operatorit të sistemit përmes aplikacioneve SCADA EMS të mirëmbajë kriterin e parametrave tension frekuencë, të menaxhoj fluksin e fuqisë, përmbushjen e lakores së kërkesës së konsumit dhe programit të shkëmbimit me kombinimin e njëkohshëm të prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneratorët dhe importi/eksporti.

Duke pasur parasysh rëndësinë e sistemit SCADA EMS, obligimeve që dalin nga ENTSO-E dhe detyrimeve nga Kodi i Operimit të Rrjetit, ka detyruar KOSTT të investoj në projektin "SCADA EMS dhe Telekomunikacioni"

Ky projekt ka përfshirë rehabilitimin, instalimin e pajisjeve RTU në më tepër se 20 nënstatione 110/xx kV, integrimin në sistemin SCADA EMS të këtyre RTU-ve dhe integrimin e 14 RTU-ve ekzistuese, duke ju mundësuar monitorim dhe komandim të sigurtë me qarqet primare, rregullim efikas të tensionit të mesëm në nivelin lokal si dhe nga Qendra Dispeçerike. Këto pajisje ju ofrojnë monitorim dhe komandim on-line të elementeve energjetike, alarmim për ndodhitë në sistem dhe ruajtjen e tyre në listën e ngjarjeve me rezolucion 1 ms dhe me kohë të saktë që merret nga serverët GPS, qendror dhe lokal.

Për monitorim, komandim të këtyre nënstationeve dhe menaxhim të SEE janë implementuar dy qendra kontrolluese (kryesore dhe emergjente) me infrastrukturë harduerike dhe softuerike moderne që mundëson funksionim të pandërprerë të sistemit edhe në rastet e defekteve të njëfishta.

Sistemi SCADA ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga gjendja fillestare si rrjedhojë e zhvillimit të rrjetit dhe kapaciteteve

transformues e. Gjatë viteve 2012/2013 është implementuar respektivisht integruar Nënstationi NS Ferizaj 2 në sistemin SCADA EMS, ky integrim është përcjell edhe me rikonfigurimin e skemës njëpolare të SEE



*Sylë Bytyqi*

dhe linjës interkonektive me Ma-qedoninë, integrimi i NS Rahoveci, integrimi i transformatorëve të tretë nga NS Prishtina 4 dhe NS Prizreni 2 në SCADA EMS.

Gjatë këtij viti është bërë komisionimi i Nënstationit NS Prizreni 2 220/110 kV dhe me sukses është realizuar inkorporimi i tij dhe i ndryshimeve tjera në NS Ferizaj 1 dhe NS Gjilani si rrjedhim i ndërrimit të qarqeve primare, në SCADA EMS.

Në fazën e implementimit janë projektet si:

- Zgjerimi i Nënstationit NS Deçani me transformatorin e tretë të fuqisë, rehabilitimi i NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3, duke përfshirë këtu integrimin e pajisjeve IED në sistemin RTU përmes protokollit IEC 61850;

- Konfigurimi i serverëve OIG për shkëmbimin e të dhënave në mes KOSTT dhe TSO-ve tjera përmes protokollit ICCP;

- Tani është në përgaditje e sipër integrimi i transformatorëve të instaluar nga KEK-u në nënstationet NS Deçani; NS Prizreni 1; NS Ferizaj 1 së bashku me dy fusha të linjave 110 kV.

- Integrimi i Nënstationeve NS Prishtina 7, NS Gjilani 5.

- Instalimi dhe integrimi i NS Vallaçi dhe HC Ujmani.

*Sylë Bytyqi*

## Qeveria Gjermane akordon kredinë e dytë për zhvillimin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës

**M**ë 23 Shtator 2013, Ministri i Financave, z. Besim Beqaj, Presidenti i parë i KfW për Evropën Juglindore dhe Turqinë z. Christoph Tiskens, znj. Sirje Porder, përfaqësuese e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Naim Bejtullahu, në ambientet e Ministrisë së Financave në Prishtinë, kanë nënshkruar Marrëveshjen për Kredi përmes së cilës do të bëhet financimi i disa projekteve për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë.

Kjo është kredia e dytë komerciale që Qeveria Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) i akordon Republikës së Kosovës, me qëllim të financimit të gjashtë projekteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a).

Marrëveshja parasheh sigurimin e kredisë komerciale afatgjate nga KfW me kushte kredituese të buta në vlerë prej € 23,5 milion nga e cila € 15,5 milion me periudhë kthyesë prej 15 viteve dhe €8 milion me periudhë kthyesë prej 40 viteve, si dhe financimin shtesë në formë granti nga Komisioni Evropian në vlerë prej € 7.3 milion përmes programit IPA.

Gatishmëria e KOSTT për të vazhduar me financimin e projekteve zhvillimore përmes kredive komerciale, dëshmon se KOSTT është në rrugë të mirë drejt vet qëndrueshmërisë së plotë financiare.

Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes për Kredi, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Naim Bejtullahu duke falënderuar Qeverinë Gjermane për kredinë e akorduar, si dhe Komisionin Evropian për grantin, theksoi "KfW vazhdon të jetë partner strategjik i KOSTT në përkushtimin për të zhvilluar më tutje Sistemin e Transmisionit të Kosovës".

Implementimi i projekteve në fjalë, që njëherit janë pjesë e Planit Zhvillimor të Transmisionit 2013-2022, do të kenë ndikim të theksuar në

sigurinë, besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit, rritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese të energjisë elektrike, plotësimin e kriterit N-1 dhe ngritjen e performancës operuese të Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës.

KOSTT sh.a është e përkushtuar që në mënyrë të vazhdueshme të zhvillojë dhe modernizojë



Sistemin Transmetues të Republikës së Kosovës, gjë që paraqet parakusht për zhvillimin ekonomik dhe industrial të vendit.

Projektet e KOSTT sh.a që do të financohen përmes kredisë

1. Instalimi i transformatorit të dytë 300MVA në NS 400kV Peja 3 dhe Ferizaj 2
2. Instalimi i OPGW në linjat interkonektive
3. Instalimi i grupeve matëse për linjat interkonektive
4. Ndërtimi i një linje të re 110kV NS Peja 3 – NS Peja 1
5. Ndërtimi i stabilimenteve të tensionit të lartë nga AIS në GIS në NS 110/35kV në Peja 1 dhe instalimi i fushave të reja të transformatorëve të tensionit të mesëm
6. Revitalizimi i linjës 126/2 110kV NS Peja 2 – NS Deçan



## Krijimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri

**P**ër të qenë në harmoni me politikat e Bashkimit Evropian dhe duke parë nevojën për investime në sektorin e energjisë elektrike, qeveritë e Evropës Juglindore (Regjioni i EJL) kanë iniciuar ristrukturimin e sektorit të energjisë elektrike me qëllim të promovimit të konkurrencës në tregun me shumicë dhe tregun me pakicë të energjisë elektrike, promovimit të investimeve dhe eficiencës në shfrytëzimin e burimeve të energjisë elektrike.

Kosova dhe Shqipëria si shtete të regjionit të EJL dhe pjesë e proceseve të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, karakterizohen si shtete me tregje të vogla të energjisë elektrike, me mungesë të kapaciteteve gjeneruese dhe llojshmërisë së tyre për të mbuluar kërkesën në rritje. Gjithashtu karakterizohen me gjendje të vështirë në sektorin e industrisë elektrike me varësi nga importi i energjisë elektrike nga tregjet regjionale jo likuide dhe jo transparente dhe me humbje të mëdha teknike në rrjetin e shpërndarjes. Kompanitë e mëdha publike prodhuese në të dyja shtetet karakterizohen si jo eficiente dhe me shfrytëzim jo optimal të burimeve të energjisë. Situata vështirësohet edhe më shumë sepse të dyja shtetet kanë shkallë të lartë të papunësisë dhe standard të ulët të jetesës gjë që për Qeveritë ndërmarrja e aktiviteteve aq te nevojshme në reformimin e tregut të energjisë është shumë e ndjeshme nga aspekti social. Këto fakte janë sfiduese për themelimin e një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike.

Të dyja shtetet kanë mungesë të kapaciteteve gjeneruese (e cila është më kritike në Shqipëri gjatë sezoneve të thata për shkak të përqindjes së lartë të kapaciteteve hidrike) dhe adekuate për të siguruar furnizim të sigurtë me energji elektrike gjatë vitit. Si pasojë, në disa periudha balancimi në mes prodhimit dhe konsumit bëhet duke shkyçur konsumatorët e energjisë elektrike. Aktualisht, Kosova ka kapacitete gjeneruese jo fleksibile (98% termocentrale me linjit) për të

mbuluar kërkesën në rritje dhe kapaciteteve balancuese (rezerva balancuese) për ofrimin e shërbimeve ndihmëse si rregullimi primar, sekondar dhe



*Skender Gjonbalaj*

terciar. Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit, vlerësuar 12.5 miliard ton dhe aktualisht është burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike në vend. Nga ana tjetër Kosova nuk ka ende të zhvilluar rrjetin e gazit dhe ka të limituar burimet e ripërtëritshme të energjisë elektrike. Deri më tani nuk janë bërë studime detale për të vlerësuar potencialet e burimeve të ripërtëritshme në Kosovë, ashtu që linjiti do të vazhdojë të jetë edhe më tutje burimi kryesor i energjisë elektrike. Kapacitetet prodhuese në Shqipëri janë pothuaj 100% hidrike prandaj siguria e furnizimit gjatë vitit varet nga kushtet hidrike. Tre hidrocentralet kryesore gjenden në veri në Kaskadën e lumit Drin të cilat prodhojnë 88% të energjisë totale në Shqipëri.

Nga aspekti i tregut, në të dyja shtetet tregu me shumicë kufizohet nga importi dhe eksporti kurse kompanitë për furnizim me energji elektrike kanë kontrata afatgjata me kompanitë prodhuese në pronësi të shtetit. Në të dyja shtetet, në tregjet nacionale me shumicë mbizotërojnë kompanitë prodhuese në pronësi të shtetit ndërsa tregtimi ndërkufitar sado pak konkurrues varet nga kapacitetet transmetuese interkonektive në dispozicion dhe procesi i menaxhimit të tyre.

Pengesa kryesore për hapjen e një tregu konkurrues janë tarifat e rregulluara që edhe më tutje janë nën nivelin e mbulimit të kostos të kërkuar nga kompanitë furnizuese me energji elektrike. Ky nivel i tarifave jep sinjale të gabuara për investime dhe për konsumin e energjisë elektrike dhe nuk është nxitje për konsumatorët që të zgjedhin furnizues tjerë të pavarur. Mungesa e kapaciteteve prodhuese në





periudhën kur kërkesa është e lartë dhe importi i energjisë elektrike është i pamundur për arsye të çmimit të lartë (kostoja e të cilit nuk mbulohet me tarifatat aktuale) apo mungesa e kapaciteteve ndërkufitare transmetuese kanë ndikuar që balancimi i sistemit të bëhet me shkyçjet e konsumatorëve.

Qëllimi kryesor i Qeverive të të dyja shteteve mbetet siguria e furnizimit me energji elektrike dhe themelimi i tregut konkurrues që do të jepet sinjale për investime në të ardhmen në kapacitete prodhuese, zhvillimin e rrjetit dhe shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të energjisë elektrike nga ana tjetër. Duke pas parasysh karakteristikat e përmendura më lartë arritja e këtyre objektivave në një treg të integruar do mundëson shfrytëzimin më efikas dhe optimal të burimeve të energjisë elektrike.

Karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri sygjerojnë se me integrimin e tregut do të përfitonin konsumatorët e të dyja vendeve dhe do të bëhej shfrytëzimi më optimal i kapaciteteve gjeneruese. Tregjet afatshkurta në Kosovë dhe Shqipëri janë të pazhvilluara përveç shkëmbimeve emergjente sipas rastit. Nuk ka treg të organizuar një ditë para dhe duke pasur parasysh madhësinë e tregjeve nacionale gjasat për organizimin e tregjeve të tilla janë të vogla. Kombinimi i kapaciteteve prodhuese dhe kapaciteteve interkonektive mundësojnë

integrimin e plotë të tregut për periudha të ndryshme kohore. Operimi si një zonë e vetme (biding zone) me ç'rast kapacitetet interkonektive në mes Kosovës dhe Shqipërisë do të konsideroheshin si linja të brendshme d.m.th. nuk ka nevojë për rezervim të kapacitetit interkonektiv, mundëson shfrytëzimin optimal dhe efikas të kapaciteteve prodhuese, rezervave balancuese dhe rrjetit transmetues. Gjithashtu edhe siguria e

furnizimit do të rritej me operim të përbashkët të tregut të energjisë elektrike.

Nga aspekti legal, mirë funksionimi i një tregu të përbashkët kërkon harmonizim të kornizës ligjore, rregullative, operative dhe tregtare të tregjeve nacionale ekzistuese në Kosovë dhe Shqipëri. Po ashtu është i nevojshëm një bashkëpunim ndërmjet akterëve në tregun e Kosovës dhe Shqipërisë.

Themelimi i një tregu të përbashkët si një zonë e vetme tregtare për të gjitha afatet kohore do të jetë në harmoni me modelin e planifikuar të tregut të energjisë elektrike të BE e që është po ashtu edhe objektivë e Komunitetit të Energjisë për EJT. Në Procesin e ardhshëm të bashkimit të tregjeve (market coupling) tregu i përbashkët Kosovë- Shqipëri do konsiderohej si një zonë tregtare dhe do të bashkohej me zonat tjera në tregjet një ditë para (day ahead) dhe ditore (intra day). Në periudha afatgjata, kapacitetet ndërkufitare me zonat tjera do të alokohen në harmoni me Kodin e Rrjetit për alokim paraprak që është duke u përpiluar nga ENTSO-E. Në tregun e përbashkët Kosovë- Shqipëri do të mund të tregtohen produkte standarde bazuar në kërkesat e tregut dhe liferimi do të bëhet në zonën e përbashkët pavarësisht ku apo tek cila TSO është bërë nominimi i programeve.

*Skender Gjonbalaj*

## KOSTT sh.a investon në përmirësimin e kualitetit të furnizimit me energji elektrike në rajonin e Kosovës Juglindore

**N**ë kuadër të përkushtimit të vazhdueshëm të KOSTT sh.a, për zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës, krahas projekteve të tjera, në vjeshtë të këtij viti u finalizua projekti për Rehabilitimin e Stabilimenteve të Tensionit të Lartë në Nënstacionet NS 110/35/10 kV Ferizaj 1 dhe NS 110/35 kV Gjilani 1.

Ky projekt në vlerë prej afro 1 milion Euro, është pjesë e Planit Zhvillimor dhe Investiv të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a dhe është financuar nga buxheti i KOSTT.

Me zbatimin e projektit për rehabilitimin e Nënstacioneve në fjalë, është përmirësuar kualiteti i furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit për konsumatorët që furnizohen nga NS Ferizaj 1 dhe NS Gjilani 1, dhe njëkohësisht do të ketë ndikim në rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës. Për më tepër, do të mundësohet krijimi i kushteve për zhvillim industrial dhe ekonomik të pjesës juglindore të vendit tonë.



Lajme shkurt

### **Bordi i Drejtorëve të KOSTT emëron z.Naim Bejtullahu, Kryeshef Ekzekutiv të KOSTT sh.a**

**P**as një procesi të hapur transparent dhe konkurrues, në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve të KOSTT, me 4 Nëntor 2013, ka emëruar z. Naim Bejtullahu, Kryeshef Ekzekutiv të KOSTT sh.a. z.Bejtullahu ka ushtruar këtë funksion nga data 22 Maj 2013.

Z.Naim Bejtullahu me profesion Inxhinier Elektrik, mban një eksperiencë mbi 35 vjeçare në operim të sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes, si dhe në rregullim të sektorit të energjisë si komisioner. Para emërimit Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT, z.Bejtullahu ka ushtruar funksionin e zv.Kryeshefit për Zhvillim.

Ndryshimet në strukturën udhëheqëse të kompanisë, vijnë pas emërimit të z.Fadil Ismajli Ministër i Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës.



## Përvojë nga trajnimi në Japoni për konservim të energjisë në sektorin publik dhe komercial

**K**OSTT sh.a. që prej themelimit e tutje, me qëllim të ngritjes dhe avancimit të njohurive profesionale për stafin e vet, ka përkrahur në forma të ndryshme posaçërisht gjeneratat e reja të inxhinierëve duke iu mundësuar të marrin pjesë në trajnime, studime dhe seminare të ndryshme jashtë vendit.

Në kuadër të këtyre mundësive dhe përkrahjes së ofruar nga KOSTT, prej 25 Gusht 2013 deri 11 Tetor 2013(7 javë) kam qëndruar në Japoni, respektivisht në qytetin Kitakyushu/Prefektura e Fukuokes/Kyushu Japoni, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin e quajtur "Promovimi i konservimit të energjisë në sektorin publik dhe komercial". Ky trajnim është organizuar dhe mbështetur financiarisht nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar – JICA (ang. Japan International Cooperation Agency) përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht përmes Ministrisë së Integritimit Evropian. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë pjesëmarrës nga disa vende të ndryshme të botës, sikurse që janë: Egjipti, Arabia Saudite, Algjeria, Jordani, Filipinet, Kosova, Serbia dhe Turqia.

Në kuadër të këtij trajnimi, janë shtjelluar shumë tema të ndryshme si dhe janë realizuar shumë vizita të ndryshme sa i përket konservimit të energjisë, mënyrës së kursimit të energjisë, auditimit të energjisë për ndërtesa, përzgjedhjes dhe përdorimit të pajisjeve me eficiencë të lartë, etj.

•Temat kryesore që janë shtjelluar gjatë këtij trajnimit kanë qenë:

- Njohja me sistemin ekzistues të ligjeve të energjisë në Japoni;
- Standardet e menaxhimit të energjisë;
- Rregullat për konservimin e energjisë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- Promovimi dhe informimi i njerëzve mbi rëndësinë e konservimit të energjisë;
- Auditimi i energjisë në objekte komerciale dhe publike;
- Mënyrat për praktikimin e konservimit të energjisë në ndërtesa publike;
- Kursimi i energjisë në pajisjet për ndriçim, ngrohje dhe kondicioner të ajrit, etj.



Konservimi i energjisë është mënyrë bashkëkohore e cila aplikohet për zvogëlimin e konsumit të energjisë nëpër objekte dhe ndërtesa të ndryshme. Zvogëlimi i konsumit të energjisë përmes konservimit të energjisë nënkupton kursimin e energjisë nga shpenzimet e panevojshme të energjisë që përdoret pa arsye për shërbime të vazhdueshme. Konservimi i energjisë nuk nënkupton efikasitetin e energjisë.

Mirëpo edhe efikasiteti i energjisë e edhe konservimi i energjisë kanë ndikim të dukshëm në reduktimin e emetimit të gazit CO2 në mjedis.

Në përfundim të trajnimit secili prej pjesëmarrësve është pajisur me certifikatë mbi njohuritë e fituara dhe për përfundimin me sukses të trajnimit.

*Rexhep Selimi*

### **Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Janar-Shtator 2013**

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë), në mbledhjen e Bordit të mbajtur më 23 janar 2013, në bazë të kërkesës së KOSTT ka marrë vendim për aprovimin e Planit Zhvillimor të Transmisionit 2013-2022. ([V 501 2013](#))

Në mbledhjen e Bordit të ZRRë të mbajtur me 01 mars 2013, në bazë të kërkesës së KOSTT është aprovuar Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës. ([V 505 2013](#))

Me 22 mars 2013, në bazë të aplikacionit të KOSTT për të Hyrat dhe Tarifat e lejuara, Bordi i ZRRë ka marrë vendim të aprovojë të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) që do të mbulojnë nga tarifatat dhe ngarkesat e rreguluara që do të aplikohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut sh.a (KOSTT) përmes tarifave dhe ngarkesave për periudhë rregullative 5 vjeçare duke filluar nga 01 prill 2013 deri me 31 mars 2017. ([V 518 2013](#))

Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 10 korrik 2013, në bazë të kërkesës të KOSTT, ka marrë vendim të aprovojë ngarkesat që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, që do të hyjnë në fuqi nga data 01 prill 2013. ([V 529 2013](#))

Në mbledhjen e Bordit të ZRRë të mbajtur me 02 maj 2013, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të aprovohen "Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS), "Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit" si dhe "Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut". ([V 533 2013](#))

Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 28 qershor 2013, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim që ti lejohet KOSTT sh.a derrogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit si në shtojce të këtij vendimi. ([V 553 2013](#))